



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

---

Numri i lëndës: 2021:074517  
Datë: 22.04.2024  
Numri i dokumentit: 05600280

C.nr.263/2021

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Betim Behluli, me bashkëpunëtorin profesional Armond Omega, në çështjen juridike të paditëses Republika e Kosovës, Qeveria e Kosovës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Pyjore e Kosovës, Drejtorati Kordinues Rajonal, me seli në Prizren, kundër të paditurit D.A.S, nga fshati Zatriq, Komuna e Rahovecit, për kompensimin e dëmit, vlera e kontestit 308,48 €, jashtë shqyrtimit me dt.22.04.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**PËR SHKAK TË PADEGJUESHMËRISË (MOSBINDJES)**

MIRATOHET në tërësi kërkesë – padia e paditëses Republika e Kosovës, Qeveria e Kosovës, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë, dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Pyjore e Kosovës, Drejtorati Kordinues Rajonal, me seli në Prizren, ashtu që të DETYROHET i padituri D.A.S, nga fshati Zatriq, Komuna e Rahovecit, që në emër të kompenzimit të dëmit t'ia paguaj shumën prej 308,48 €, me kamat ligjore prej 8%, nga dita e paraqitjes së padisë datë 07.04.2021, e gjerë te pagesa definitive, e të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së Aktgjykimit, e nën kërcënim të përbarimit me dhunë.

**A r s y e t i m**

Pala paditëse në padi ka theksuar se i padituri bazuar në aktgjykimet K.nr.275/19, të datës 04.09.2020, K.nr.84/19, të datës 04.09.2020, me të cilat aktgjykimet shpallet fajtor i pandehuri D.S, për shkak të veprës kundërvajtëse, nga neni 36,2 pika a, të Ligjit për Pyjet e Kosovës, nr.2003/3 si dhe Ligjit mbi ndryshim plotësimin e Ligjit për Pyjet e Kosovës me nr.2004/40 dhe konform nenit 35 të LMK-së.

Në bazë të provave si Aktgjykimet e Gjykatës Themelore Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni për Kundërvajtje, K.nr.275/19, të datës 04.09.2020, dhe K.nr.84/19, të datës 04.09.2020, i padituri është shpallur përgjegjës për shkak të kundërvajtjes nga neni 36,2 pika a, të Ligjit për Pyjet e Kosovës, nr.2003/3 dhe i njëjti është dënuar me gjobë.

Gjykata në kuptim të nenit 394 të Ligjit për procedurën kontestimore nr.38/2008 i publikuar në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës” me dt. 24.06.2022, i ka dërguar të paditurit padinë dhe Aktvendimin për dhënien e përgjegjës në padi.

Duke e bërë shikimin në flete dërgesën për dorëzim personal konstatohet se i padituri i lartpërmendur e ka refuzuar personalisht Aktvendimin C.nr.263/21 të dt. 24.06.2022, padinë dhe provat me dt.28.06.2022, mirëpo edhe pse ka kaluar afati i paraparë për dhënien e përgjegjës në padi, i njëjti nuk e ka parashtruar përgjigjen në padi, andaj duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 150.1 të LPK-së, të larte cituar Gjykata mori Aktgjykim për shkak të pa dëgjueshmërisë (mosbindjes) ndonëse janë plotësuar kushtet siç më poshtë vijojnë:

a) Të paditurit i është dorëzuar në mënyrë të rregullt padia, provat materiale dhe thirrja aktvendimi për dhënien e përgjegjës në padi,

b) Themelësia e kërkesë-padisë rezulton nga faktet e treguara në padi, dhe

c) Faktet mbi të cilat mbështetet kërkesë-padia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi.

Andaj, në kuptim të nenit 160.6 të Ligjit për procedurën kontestimore janë dhënë vetëm arsyet e sipërcituara që e justifikojnë marrjen e këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC**  
C.nr.263/2021, më 22.04.2024

B. Profesional  
Armond Omega

Gjyqtari  
Betim Behluli

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa paraqitet nëpërmjet të kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit, Divizioni Civil në Prishtinë.